

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 23, datë 03.10.2017

**Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake
për kryerjen e procesit të kompensimit**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 39, pika 5, të nenit 42 pika 7, dhe të nenit 52 pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, nenit 22, pika 1, shkronja “a”, të nenit 24 pika 5, të nenit 25 si dhe Aneksit 4 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.7.2016, pas shqyrtimit të raportit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Përzgjedhjen e bankave anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në listën paraprake të bankave agjente, si vijon:
 - Banka Kombëtare Tregtare SHA renditet në vend të parë.
 - Banka Raiffeisen SHA renditet në vend të dytë.
 - Banka Intesa SanPaolo SHA renditet në vend të tretë.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për njoftimin e bankave të përzgjedhura fituese dhe për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës tip për kryerjen e kompensimit të depozitave me to.



KËSHILLI DREJTUES

3. Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit ngarkohet për kryerjen e rivlerësimit vjetor të përputhshmërisë të bankave të përzgjedhura në listën paraprake me kriteret e përgjithshme dhe teknike.
4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikqyrës lidhur me këtë vendim.
5. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar